



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. 105 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 12/ 08 / 2025

VENDIM

Nr. 26, datë 12/08/2025

PËR

**KRITERET E DHËNIES SË LICENCAVE TË PROJEKTIMIT DHE TË NDËRTIMIT TË
DIGAVE E TË DAMBAVE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Mirëmbajtjen e Digave dhe Dambave", neni 4, pika A/f, Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e datës 12.08.2025 mori në shqyrtim kriteret për dhënie të licencave të projektimit dhe të mbikqyrjes e kolaudimit të digave e të dambave sipas kërkesave të legjislacionit të mësipërm në fuqi.

Gjatë mbledhjes u shqyrtuan dhe u diskutuan kriteret e dhëna në rregulloren ekzistuese për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit, projektimit dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të ndërtimit të miratuar me VKM Nr. 943, datë 28.12.2016. Nga shqyrtimi i lidhjeve 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje është venë re se emërtimet e dhëna në pikën 5 të lidhjes 2 dhe pikave 6 tek lidhja 3 nuk përfshijnë të gjitha digat dhe dambat sipas kërkesave të legjislacionit të mësipërm në fushën e digave. Konkretisht, në këto lidhje jepen kategori për projektim vetëm të digave të mëdha dhe jo për dambat e mëdha. Gjithahstu, përkufizimi për digat e mëdha nuk është në përputhje me kërkesat e legjislacionit të mësipërm dhe të përcaktimeve të dhëna nga ICOLD. E njëjta problematikë është edhe në përcaktimet e lidhjes 3 të kësaj rregulloreje.

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve të pranishëm, KKDM

VENDOSI:

- 1- Të miratoj kriteret për dhënie të licencave të studimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të digave dhe dambave si me poshtë.
 - a. Në lidhjen 2 të kësaj Rregulloreje për kategoritë në fushën e Projektimit të Veprave Hidraulike të jetë kategoria 5/a për projektimin e digave dhe dambave të mëdha me lartësi mbi 15 m ose me lartësi 10-15 m por me kushtin që gjatësia e tyre të jetë mbi 500 ml dhe vëllimi i ujit për digat ose mbetjeve sterile për dambat të jetë mbi 1 milion m³. Kjo kategori e licencave të jepet për shoqëri ose persona juridike me drejtues teknik të kualifikuar në Inxhinieri hidroteknike, ndërtim dhe gjeologe/gjeoteknike me eksperiencë mbi 10 vjet.
 - b. Në lidhjen 2 të kësaj Rregulloreje për kategoritë në fushën e Projektimit të Veprave Hidraulike të jetë kategoria 5/d për projektimin e veprave ujitje, kullimi, impiante vaditese, diga dhe dambave të vogla që nuk plotësojnë kushtet për diga apo damba të mëdha, sifona, kapërderdhësa, rrymëshpëjtues, porta, priza, tombino. Kjo kategori e licencave të jepet për individë të kualifikuar në Inxhinieri hidroteknike dhe ndërtim me eksperiencë mbi 5 vjet.
 - c. Në lidhjen 3 të kësaj Rregulloreje për kategoritë në fushën e Mbikqyrjes dhe Kolaudimit të punimeve të ndërtimit të jetë kategoria NP 6.a për Digat dhe Dambat e Mëdha me lartësi mbi 15 m ose me lartësi 10-15 m por me kushtin që gjatësia e tyre të jetë mbi 500 ml dhe vëllimi i ujit për digat ose mbetjeve sterile për dambat të jetë mbi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

1 milion m³. Kjo kategori e licencave të jepet për shoqëri ose persona juridike me drejtues teknik të kualifikuar në Inxhinieri hidroteknike, ndërtim dhe gjeologe/gjeoteknike.

- d. Në lidhjen 3 të kësaj Rregulloreje për kategoritë në fushën e Mbikqyrjes dhe Kolaudimit të punimeve të ndërtimit, Punime të Përgjithshme Ndërtimi, të jetë kategoria NP 6.b për Digat dhe Dambat e vogla që nuk plotësojnë kërkesat e digave dhe dambave të mëdha të dhëna më sipër. Kjo kategori e licencave të jepet për individë të kualifikuar në Inxhinieri hidroteknike, ndërtim dhe gjeologe/gjeoteknike me eksperiencë pune mbi 15 vjet.
- e. Në lidhjen 3 të kësaj Rregulloreje për kategoritë në fushën e Mbikqyrjes dhe Kolaudimit të punimeve të ndërtimit, Punime Speciale Ndërtimi, të jetë kategoria NS 22 për Sistemet e monitorimit dhe Sistemet e Alarmit në Digat dhe Dambat e mëdha. Kjo kategori e licencave të jepet për shoqëri ose persona juridike me drejtues teknike të kualifikuar në Inxhinieri hidroteknike, ndërtim, IT dhe gjeologe/gjeoteknike me eksperience pune mbi 15 vjet.

- 2- Ti propozoj Ministrisë së Infrastrukturs dhe Energjië (MIE) si dhe Këshillit të Ministrave miratimin e këtyre kategorive të dhëna më sipër në fushën e studimit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të cilat janë të nevojshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi në sektorin e digave.

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të Mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkuara në këtë vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

PËR KOMITETIN KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA

KRYETARI

Arjan JOVANI

